REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr. ____ prot. Tiranë, më,___,___2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI "SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E TOKAVE DHE AKTIVEVE NATYRORE" PËR NEVOJAT E DPPGJ PER VITIN 2024**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "**Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore**" për nevojat e DPPGJ per vitin 2024.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT** (**CPV**): **FPP)** 77721 15 00-7

**VLERA E FONDIT LIMIT**: **6 646 500 (**gjashtemilion e gjashteqind e dyzet e gjashtemije e peseqind**) lekë pa TVSH** me burim financimi buxhetin afati mesëm 3 vjecar 2024-2026

I mbajtur sot më date **30.08.2024,** në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur i thjeshtuar» , Në bazë të nenit 21, pika 2, 49 të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",lloji i kontratës shërbim **me afat ekzekutimi 3 muaj nga data e lidhjes se kontrates** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kritereve për kualifikim nga specialistet e fushes për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**<u>Grafiku i Shërbimit do te jete si me poshte;</u>**

| KRASITJE BIMESISE DEKORATIVE | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LLOJI SHERBIMIT | VENDNODHJA | MUAJI 1 | | | | MUAJI 2 | | | | MUAJI 3 | | | |
| | | Java 1 | Java 2 | Java 3 | Java 4 | Java 1 | Java 2 | Java 3 | Java 4 | Java 1 | Java 2 | Java 3 | Java 4 |
| Krasitje/ Ngritje kurorash/ Sistemim kurorash | Njesia Nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5 | | | | | | | | | | | | |
| Krasitje/ Ngritje kurorash/ Sistemim kurorash | Njesia Nr. 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 | | | | | | | | | | | | |
| Krasitje/ Ngritje kurorash/ Sistemim kurorash | Rruget kryesore | | | | | | | | | | | | |

**Afatet e ekzekutimit:**

**Afati i kryerjes së shërbimit: 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.**

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj proçedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur me urdhër Nr.431 Prot datën 12.08.2024 për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kritereve te vecanta teknike, të procedurës ne reference.

*Data e hapjes së ofertave planifikuar eshte 12.09.2024 Ora: 11:00*

- *www.app.gov.al*
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 9 të DST –ve, kritere, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, jane të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (, *sipas shtojcës 9)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

**2.2 KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare vjetore e të cilës të jetë **jo më e vogël se 40%** e vleres se parashikuar te kontrates

***Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ,të ndryshuar, ku parashikohet se*: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose loti , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit*[1]*, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, të ndryshuar: *"1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe*

[1] Ndryshuar me Vendimin Nr.710 datë 24.11.2021

*ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare[2].*"

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 *(tre)* viteve të fundit (2021, 2022, 2023),** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",të ndryshuar, nenit 19 te VKM nr. 498 date 01.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi *të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar* ***në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës****, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.";*si dhe pikës c) **të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 *"Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar",*** ku parashikohet se:*"Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.",* Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 *"Për tatimin mbi të ardhurat"*, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto*

[2] Riformuluar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

*dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentacionin provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike*

***Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr.431 Prot datën 12.08.2024, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:***

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogel se 20 % t**ë vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

* Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

* Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

*Plotesimi i njerit nga kushtet e siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme*

***Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa ”b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë **ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,** që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

Bazuar ne piken 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “***Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe***

***nisjes së afateve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i **kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari** dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*"

**2.3.2.** Operatori Ekonomik ofertues Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë, licencë profesionale:

Sipas modelit të lëshuar nga institucionet e autorizuara me dispozitat në fuqi për lëshimin e dokumentit të tillë. Licenca duhet të përmbajë të paktën kategoritë në klasifikimin e mëposhtëm:

- **NP-12 A**
- **N.S- 3 A**

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

**Argumentimi**: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021"Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat sherbimi" pika 6, si dhe nenin 77 të LPP. Nivelet dhe kategoritë e licencës janë bazuar në VKM 943 datë 28.12.2016 dhe në Vendimin nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi A (edhe për herë të parë) 0 - 20 milion lekë.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kritere të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, *ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.*

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve apo mirembajtje ne rastin konkret respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas sherbimit të hartuar për këtë objekt.

- Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP-12 A** "Punime të inxhinierisë mjedisore": *Konsiderohen ndërtime, **mirëmbajtje** ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të*

*kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte*

- Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S- 3 A** "Impiante ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues)": *Konsiderohet montimi , mirembajtje ose ristruktrurim i impianteve transportuese, ashensore, shkalle levizese, ngritese dhe te transportit, komplet dhe te lidhur me cdo punim murature plotesuese ose ndihmese qe jane realizuar ose jane duke u realizuar ne punimet e pergjithshme.*

Nisur nga tipologjia e shërbimit, sqarojmë se AK nuk i ka kapacitetet tekniko-profesionale për t'i kryer shërbimet e mirëmbajtjes së bimësisë dekorative me anë të forcës së vetë punëtore dhe mjeteve në dispozicion. Në këtë kuadër është e domosdoshme që shërbimi i krasitjes së drurëve dekorativ të kryhet nëpërmjet proçedurës së prokurimit nga OE të specializuar, të cilët i kanë të gjitha kapacitetet tekniko-profesionale për të kryer me sukses shërbimin në fjalë. Liçenca **NS-3 A** i shërben AK për të njohur kapacitetet teknike të OE potencialisht fitues, si dhe i jep siguri AK se shërbimi do të kryhet në respekt të kushteve teknike dhe të sigurisë në punë. Sqarojmë gjithahshtu se domosdoshmëria e liçencës NS-3-A lidhet me faktin se në disa zona (referuar kërkesave të ardhura dhe të protokolluara pranë DPPGJ nga institucione apo qytetarë, gjithashtu referuar kontratave të ngjashme në ndërhyrjet për mirëmbajtjen e pemëve nëpërmjet proçesit të krasitjes së drurëve dekorativë) nuk mund të ndërhyet nëpërmjet përdorimit të mjeteve si vinç me kosh apo vinç autokullë, pasi është e pamundur për këto mjete për shkak të terrenit apo mungesës së rrugës, apo ngushtësisë së rrugës të operohet për kryerjen e këtij shërbimi. Në këto kushte AK e gjykon të nevojshme (referuar edhe materialit grafik bashkëngjitur) që për kryerjen e shërbimit të proçedohet me montimin e **sistemeve ngritëse, të lëvizshme (platforma ngritëse apo/ose skela) per** të kryer proçesin e mirëmbjajtjes (krasitjen) e drurëve dekorativë, në respekt të kushteve të sigurisë teknike në punë por edhe në respekt të sigurisë së qytetarëve dhe ambientit rrethues ku do të kryhet shërbimi.



<u>Kjo kategori licence i referohet krasitjes se pemeve te cilat jane te nje lartesie te konsiderueshme dhe eshte e domosdoshme mjeti/mjetet transportuese ngritese ne te cilen qe do te realizohet ky sherbim.</u>

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në kete kontrate sherbimi;

| **Kategoria e kërkuar** | **Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës** | **Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse** | **Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive** | **Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse** |
|---|---|---|---|---|
| **N.P - 12 A** | "Punime të inxhinierisë mjedisore" | Të gjitha sherbimet që do realizohen jane punime të inxhinjerisë te cilat kane lidhje | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | me mirembajtjen e zakonshme dhe jashtezakonshme kryesisht te pemeve te llojeve te ndryshme. | | VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar. |
| **NS-3 A** | “Impiante ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues)” | Te gjitha sherbimet te cilat duhet të angazhohen mjete dhe makineri ngritëse në lartësi të madhe deri 30 metra. Për të garantuar mbarëvajtjen operatori ekonomik duhet të ketë licensë në këtë fushë që vërteton që ka kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe të cdo lloji tjetër për të realizuar me sukses shërbimin që kërkohet. | A | Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar |

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e sherbimit objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor** që të kenë stafin inxhinierik si më poshtë te cilin ta kete te punesuar te pakten në 3 muajt e fundit **dhe te jenë te pakten me eksperiencë pune** si më poshtë:

a. Inxhinier Agronom 1 (një)
b. Inxhinier Mekanik 1 (një)
c. Inxhinier Mjedisi 1 (një)

*Në rastin e shpalljes fitues të Operatorit Ekonomik, para lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktor do të kërkojë nga OE fitues të paraqes për fuqinë punëtore dokumentacionin (original ose kopje e noterizuar) të sipërcituar.*

Gjithashtu për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- CV
- Kontratë pune të vlefshme
- Diplomë
- Licence

***Argumentimi :*** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e meparshme për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, referuar tipologjise se kontrates.*

*Në përcaktimin e numrit te personelit kryesor specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e shërbimit objekt kontrate që kërkohet të kryhet, grafiku i shërbimit dhe kualifikimi i punonjësve (element shumë i rëndësishëm lidhur me njohuritë e tyre specifike për shërbimin që kërkohet të kryhet), gjithahshtu orët e punës dhe pagen minimale te lejuar qe*

*duhen për të përmbushur kontratën. Kualifikimi i tyre, grafiku i shërbimit tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Punësimi i një numri të caktuar te personleit kryesor , përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë.. Vendosja e kriterit për një prej 3 (tre) inxhinieresh konkretisht inxhinier mekanik, inxhinier agronom dhe inxhinier mjedisi është në përputhje me llojin e shërbimit të kërkuar.*

- ***1 (një) Inxhinier Mekanik** (për mirëmbajtjen e mjeteve), domosdoshmëria i këtij profili punonjësi lidhet me natyrën e shërbimit e gjithashtu kohën e limituar në të cilën ky shërbim do të kryhet. Theksojmë se AK nuk mund të rrezikojë mbarëvajtjen e proçesit të shërbimit për shkak të defekteve të mundshme të cilat lidhen me mirë-funksionimin e mjeteve. Për këtë qëllim specilisti i fushës gjykon se ky është një kriter i dosmodshëm **kërkesa për inxhinier mekanik*** e cila i referohet gjithashtu kriterit teknik per te cilin eshte shpjeguar dhe domosdoshmëria e liçencës **NS-3 A** dhe faktit se OE fitues potencial të proçedurës së prokurimit, bazuar në llojin e shërbimit në domsodoshmërinë e montimit të impianteve ngritëse, lëvizëse do t'u nevojitet në staf një person i specializuar për kryerjen me cilësi të' shërbimit (punimeve). Kërkesa mbështetet gjithashtu në VKM. Nr.42, datë 16.1.2008. Gjithashtu mbështetur në faktin se proçesi do të kryhet nëpërmjet mjeteve motorrike të specizalizuara, mungesa e Ing. Mekanik në gjykimin e AK do të përbënte një problematikë të mundshme në mbarëvajtjen e shërbimit.

- ***1 (një) Inxhinier Agronom** (për kujdesjen dhe mirëmbajtjen e bimësisë), domosdoshmëria i këtij profili punonjësi lidhet me natyrën e shërbimit e gjithashtu kohën e limituar në të cilën ky shërbim do të kryhet. AK kërkon siguri që shërbimi do të kryhet në standartin e duhur. Në këtë kuadër **inxhinieri Agronom**, i cili është specialist i fushës, duhet të ndjekë shërbimin nga afër për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi të mundshëm për një shërbim sa më cilësor.*

- ***1 (një) Inxhinier Mjedisi** (për kontrollin e ndotjes se mjedisit), domosdoshmëria i këtij profili punonjësi lidhet me natyrën e shërbimit e ghithashtu kohën e limituar në të cilën ky shërbim do të kryhet. AK kërkon siguri që shërbimi do të kryhet në standartin e duhur. Në këtë kuadër **inxhinieri Mjedisit**, i cili është specialist i fushës, duhet të ndjekë shërbimin nga afër për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi të mundshëm për një shërbim sa më cilësor. Domosdoshmëria e Inxhinierit të Mjedisit diktohet nga nevoja që*

*shërbimi të kryhet në mënyrën e duhur dhe gjatë shërbimit mos të hasen probleme me ndotjen e mjedisit.*

***Shenim:*** *Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

---

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar **staf teknik** per kryerjen e punimeve me objekt kontrate shërbimi si më poshtë:

a) Specialistë punimesh per lartesi 4 (kater)
b) Manovratorë-automakinistë 4 (kater)
**c)** Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave 1 (nje)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- kontratë punë te vlefshme
- diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara/licencuara nga autoritetet pergjegjese shteterore
- Dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve
- Listepagesat E-SIG 25 te 3 muajve te fundit me vule elektronike te vlefshme te verifikueshme ne sistem.

*Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpermjet kontratës së qerasë ateherë operatori ekonomik për **punonjësit manovrator** duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.*

***Argumentimi:*** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ c), pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës si dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë*

*të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Konkretisht:*

- ***4 (kater)*** *Specialiste punimesh ne lartesi te pajisur me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik, i referohet faktit se proçesi i krasitjes së bimësisë dekorative do të kryhet në një lartësi prej mbi 20 metra nga toka (20-30m).*

- ***4(kater) manovratore – automakinistë qe te jenë te pajisur me patentat perkatëse dhe Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik,*** *i referohet faktit se shërbimi do të kryhet me anë të mjeteve si vinç me kosh dhe vinç autokullë, për manovrimin e të cilave duhet dëshmia e automakinistit/manovratorit.*

- ***1 (nje)*** *Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave bazuar ne VKM 514 datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)" të rishikuar,sa i perket llojit te sherbimit ne rastet e rreziqeve gjate zbatimit te kontrates. Konkretisht:Kërkesa e mësiperme mbështetet në Ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë.Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.*

**2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për kete objekt kontrate sherbimi duhet të disponojë fuqi punëtore duke perfshire ketu, të stafit inxhinierik dhe tekniko-profesional prej minimalisht **22 persona si dhe te figurojne ne listpagesat e punonjesve** për 3 muajt e fundit me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listë - pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e fuqisë punëtore, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës. .

***Argumentimi:****Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*

*Duke marrë shkas nga përcaktimi i llojit të shërbimeve vihet re se janë një sërë zërash të cilat kërkojnë një kapacitet punëtorësh të përpjëstueshëm me numrin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor bazuar në volumin, ditët e punës, dhe kohëzgjatjes së shërbimit. Fakti i kërkesës së numrit të të punësuarve për 3 muajt e fundit i jep siguri dhe qëndrueshmëri dhe si pasoje dhe besueshmëri operatorit ekonomik.*

*Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e shërbimit objekt kontrate që kërkohet. Pasja e një stafi të tillë tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimre e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.*

*Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën* ***22 punonjësish*** *duke përfshire dhe stafin teknik që është në përputhje me llojin e shërbimit të kërkuar si dhe kohen e kryerjes se sherbimit te percaktuar ne grafikun e punes.*

*Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik ofertues duhet **të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO** te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, për të përmbushur kete kriter duhet te paraqesi konkretisht:

a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme).

b) Çertifikatën e menaxhimit Mjedisor **ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme).

c) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018, (ose ekuivalente)** (e vlefshme)

Çdo OE pjesëmarrës (çdo anëtar i grupit) në rastet e 'Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE)' duhet të paraqesë çertifikatat ISO, sipas zërave të shërbimeve që do marrë përsipër të realizojë sipas kerkeses se AK.

***Argumentimi**: Vendosja e kritereve lidhur me certifikimet ISO bazohet në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se, Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente, konkretisht:*

*Vendosja e ketyre kritereve eshte e bazuar ne faktin qe certifikatat ISO garantojne qe operatoret ekonomik zbatojne ne punen e tyre proçedura të çertifikuara ndërkombëtare për të garantuar shërbime me kualitet.*

**ISO 9001:2015**

*ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarsisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.*

*Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.*

*Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.*

**ISO 14001-2015**

*ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.*

*ISO 14001:2015 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eleminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.*

*Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.*

**ISO 45001:2018**

*Çdo kompani ka detyrimin të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.*

*ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë.*

*Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.*

*Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë.*

*Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.*

***Shenim:** Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

**2.3.7. Me anën e një deklarate,** operatori ekonomik duhet të percaktoje pergjegjesin e kesaj kontrate, pjese te stafit te tyre, duke paraqitur kontaktet, diplomën, CV-në, kontratën e punës të vlefshme brenda periudhës së realizimit të kontratës dhe librezën e punës.

**Argumentimi**: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021"Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratata sherbimi" pika 4, a , b, si dhe nenin 77, pika 4 të LPP.*

